



Numri i lëndës: 2024:026709

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05500085

C.nr.633/2024

GJYKATA THEMELORE G.-DEGA V., gjyqtari Raif Fazliu, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.H.nga fshati R., Komuna V., i përfaqësuar nga B.I., avokat në G., kundër të paditurës Komuna e V.së-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi sipas kualifikimit shkollor, vlera e kontestit 2,830.30 €, jashtë seancës, me datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit I.H.nga fshati R., Komuna V., **detyrohet** e paditura Komuna V.-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit, në emër të kompensimit të diferencës në pagë në bazë të licencimit, për periudhën nga data 01.01.2021 deri më 31.05.2021, përkatësisht për 5 muaj, t'ia paguajë nga 38.95 €, në shumë të përgjithshme 194.75 €, me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë me datë 23.01.2024, deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

II. Refuzohet e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit e kërkuar në emër të kompensimit të diferencës në pagë në bazë të licencimit, për periudhën qershor 2018 deri në 31.12.2020, përkatësisht 43 muaj, në shumën 1,674.85 €.

III. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën 99 €, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi I.H.përmes të autorizuarit të tij av. B.I., me datë 23.01.2024, në këtë gjykatë kanë ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi në bazë të licencimit, vlera e kontestit 2,830.30 €.Me padi ka theksuar se paditësi ka punuar si mësimdhënës në ShFMU "Hasan Alija" në fshatin R., Komuna V. dhe nga gjykata ka kërkuar që në emër të kompensimit të diferencës në pagë në bazë të licencimit, për periudhën qershor 2018 deri në dhjetor 2021, për 55 muaj, t'ia paguajë 19 % të pagës bazë apo nga 51.46 € në muaj, në shumë të përgjithshme 2,830.30 €¹. Bazën ligjore të kërkesëpadisë e ka mbështetur në Ligjin e Punës, Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK) si dhe në Vendimin e Qeverisë nr.

¹ Paditësi, për periudhën qershor 2018-dhjetor 2021, ka llogaritur 55 muaj mirëpo realisht bëjnë 48 muaj. Vlera e pagës bazë prej 421 €, shumëzuar me 19 % të kualifikimit shkollor, është shuma 79.99 €. Meqë paditësi është kompensuar në shumën 41.04 € (sipas listës së pagave), borxhi i mbetur për kompensim është shuma 38.95 € dhe jo siç ka kërkuar paditësi shumën 91.50 €.

01/33, të datës 29.08.2008. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë shumën 104 € për përpilimin e padisë dhe 30 € për taksën gjyqësore për padi.

E paditura, në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi obligimet e parapara nga Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës duhet të paguhen nga niveli qendror, Ministrinë përkatëse dhe anën tjetër, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit e kanë shkëputur këtë kontratë andaj rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën. Tutje ka theksuar se paditësit kanë nënshkruar kontratën e punës sipas kualifikimit mësimdhënës, kriter ky për themelimin e marrëdhënies së punës në bazë të së cilës edhe realizojnë të ardhura sipas kësaj pozite. E paditura gjithashtu është thirrur edhe në parashkrim të kërkesës së paditësit, duke theksuar se ka kaluar afati i paraparë prej tri vitesh për të realizuar këtë të drejtë andaj, gjykatës i ka propozuar që të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pas pranimit të përgjigjjes në padi, gjykata ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 dhe 399.1 të LPK-së për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, pasi për vendosjen si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi ka gjetur se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese gjendja faktike dhe as nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor meqë kërkesa e paditësit është qartazi e themeltë ndërsa, për vendosjen si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ka gjetur se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë.

Gjykata ka gjetur se faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese, se paditësi ka qenë mësimdhënës i kualifikuar me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike, paga bazë e të cilit është 421 €, ndërsa nga e paditura është kompensuar vetëm pjesërisht edhe atë vetëm në shumën 44.04 € duke i mbetur borxh nga 38.95 € për muaj, fakte këto të mbështetura nga Vërtetimi i punës, i datës 14.11.2019, Licenca nr.100001770, e datës 11.09.2012, Diploma nr. 477, e datës 23.02.1984 dhe Lista e pagave EM00019084.

Gjykata i gjeti këto prova vendimtare për vendosje në këtë çështje kontestimore, pasi janë lëshuar nga organi kompetent, brenda kufijve të kompetencës e duke provuar kështu saktësinë e thënieve në këto dokumente, ashtu siç është paraparë në nenin 329.1 të LPK-së.

Duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare e as gjendjen faktike por vetëm bazën e kërkesëpadisë, gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor, pasi themelësia e kërkesëpadisë së paditësit, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del e mbështetur në dispozitat e nenit 55. 1 të Ligjit të Punës që përcakton se: “I punësuar ka të drejtë në pagë e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90. 5 i cili ka përcaktuar: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”, lidhur me dispozitat e KKAK-së së datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, përkatësisht neni 3. 2 i cili ka përcaktuar se: “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratën Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”.

Në Vendimin e Qeverisë nr. 01/33, të datës 29.08.2008, në fuqi deri me datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik nr. 08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësit, drejtorët, zëvendës drejtorët dhe bashkëpunorët profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike 19 %, me diplomë universitare 3 dhe 4 vjeçar 27 % dhe me diplomë të 5 vjeçare, master dhe doktoraturë 35 % të pagës bazë.

Dispozitat e KKAK-së për V.n 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017-21.01.2021 dhe për V.n 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021-21.11.2022, zbatimi i të cilave është në

Numri i lëndës: 2024:026709
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05500085

përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Në këtë çështje kontestimore, gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar në tërësi paditësit pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor apo 19 % të pagës bazë, ashtu siç është përcaktuar në Vendimin e Qeverisë dhe në nenin 7, pika 1.3 dhe 1.4 e KKAK-së dhe për këtë arsye, meqë ka qenë obligim i të paditurës të bëjë këtë kompensim dhe deri më tani nuk e ka përmbushur, gjykata e detyroi të paditurën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Paditësi, detyrimin për kompensim nga e paditura e ka kërkuar për periudhën qershor 2018 deri në dhjetor 2021 mirëpo, pasi e paditura është thirrur në parashkrim të kërkesës së paditësit, gjykata vlerësoi afatshmërinë e kërkesës së saj dhe gjeti se padia është ushtruar me datë 23.01.2024, e bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, duke llogaritur 3 vite mbrapa nga data e ushtrimit të padisë (janar 2024-janar 2021), del se kërkesa e paditësit për kompensim për periudhën qershor 2018 deri në 31.12.2020, është e parashkruar.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës lidhur me faktin e zbatimit ose jo të kontratës kolektive, gjykata i gjeti të pa bazuara këto pretendime, pasi në rastin konkret baza juridike e kërkesës së paditësit buron nga Vendimi i Qeverisë. Edhe pretendimin se paditësit janë pranuar në punë sipas këtij kualifikimi dhe në kontratën e tyre të punës përcaktohen përqindjet sipas kualifikimit, për gjykatën ishte fakt jo relevant për këtë çështje kontestuese pasi përqindjet sipas kriterëve të licencimit të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë dhe në kontratë të punës kanë dallim mes vete dhe mësimdhënësit nuk kompensohen sipas këtyre kriterëve.

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të LMD-së ndërsa, për shpenzimet e procedurës në nenin 452.1 lidhur me procedurat e kontesteve me vlerë të vogël, të përcaktuar në nenin 485.1 të LPK-së dhe numrin tarifor 6 nga Tarifa e Avokatëve të Kosovës, ashtu që gjykata ia ka pranuar shpenzimet paditësit në shumën 78 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi, në shumë të përgjithshme 99 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE G. - DEGA V.

C.nr.633/2024, datë 25.03.2024

Gj y q t a r i,
Raif Fazliu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.